

## Informacion i Përgjithshëm

### Marrëveshjet e ndaluara

#### Lehtësimi nga gjobat

##### 1. Marrëveshjet e ndaluara

Marrëveshjet e ndaluara të njohura ndryshe si kartelev, janë forma më e rënde e shkeljeve të ligjit dhe parimeve të konkurrencës. Ato dëmtojnë konsumatorin duke rritur çmimet dhe vijueshmëria e tyre për një kohë të gjatë, çon në uljen e konkurrencës si dhe ul mundësinë e punësimit.

Ndërmarrjet e përfshira në këto lloje aktiviteteve ilegale dhe që duan të shkëputen dhe informojnë Autoritetet e Konkurrencës, nuk duhet të ngurojnë për shkak të gjobave të larta ndaj të cilave janë të ekspozuar. Për këto ndërmarrje parashikohen imunitet i plotë ose i pjesshëm nga gjobat, i parashikuar në Programin e Lehtësimit nga Gjobat.

Autoriteti i Konkurrencës cilëson si të dobishëm për publikun, garantimin e trajtimit si të favorizuara për ndërmarrjet që bashkëpunojnë me Autoritetin.

##### 2. Programi i Lehtësimit nga Gjobat

Qëllimi i Programit të Lehtësimit nga Gjobat, është dhënia e imunitetit ndërmarrjeve bashkëpunuese me Autoritetin e Konkurrencës, duke asistuar Autoritetin në zbulimin dhe shkatërrimin e marrëveshjeve të ndaluara/karteleve, si dhe të ndëshkojnë pjesëmarrësit në këto kartelev.

Autoriteti e konsideron bashkëpunimin vullnetar, si faktor për zhvillim ekonomik të ndërmarrjeve dhe nga ana tjetër siguron imunitet (të plotë ose të pjesshëm) nga vendosja e sanksioneve të larta për ndërmarrjet.

##### 3. Mbrojtja e informacionit për lehtësimin nga gjobat brenda institucionit

Për të mbrojtur mekanizmin bashkëpunues midis Autoritetit të Konkurrencës dhe ndërmarrjeve, Autoriteti i Konkurrencës siguron mbrojtje për informacionin e depozituar në rastet e lehtësimit nga gjobat.

Informacioni i disponueshëm në rastet e lehtësimit nga gjobat, nuk mund të përdoret nga institucione të tjera të konkurrencës për të filluar një hetim.

Informacioni i dhënë nga një aplikim për lehtësim ose mbledhja e informacionit për këtë qëllim, mund të shkëmbehet mes dy autoriteteve homologe, në rrethanat e mëposhtme:

- Kur vetë aplikanti jep pëlqimin e tij për realizimin e shkëmbimit të informacionit; ose
- Aplikanti ka aplikuar për lehtësim nga gjoba në të dy autoritetet në të njëjtin rast.

#### **4. Modeli i programit për lehtësimin nga gjobat**

Autoriteti i Konkurrencës, kur plotësohen kushtet për dhënien e lehtësimit nga gjobat, angazhohet me shkrim, për të mos përdorur Informacionin e dhënë ose çdo informacion që mund të marrë pas datës së dhënies së informacionit, me qëllim për të vendosur sanksione ndaj ndërmarrjes aplikuese, filialeve të saj ose punonjësit. Një kopje e angazhimit me shkrim i dërgohet kërkuarit.

##### ***Qëllimi i programit të lehtësimit nga gjobat***

Programi është i bazuar në përvojat e përbashkëta të Autoriteteve Homologe që kanë operuar me një program lehtësimi për një numër vitesh dhe ka dy objektiva kryesore:

Së pari, Programi ka për qëllim vënien në zbatim të një programi të tillë të lehtësimit nga gjobat;

Së dyti, ajo përcakton një model të aplikimeve me shkrim, për të lehtësuar barrën e ndërmarrjeve.

Programi përcakton një kuadër për shpërblimin e bashkëpunimit nga ana e ndërmarrjeve, të cilat janë palë në marrëveshjet dhe praktikatat që janë objekt të tij.

Programi ka të bëjë me marrëveshjet e fshehta/kartelet. Elemente të veçanta që përbëjnë vetë marrëveshjen e fshehtë dhe që përbëjnë thelbin e kësaj marrëveshjeje, janë të vështira për t'u zbuluar dhe nuk janë të njohura për publikun apo për klientët apo furnitorët.

Kartelet përbëjnë shkelje shumë të rënda të rregullave dhe parimeve të konkurrencës, të cilat janë shpesh jashtëzakonisht të vështira për t'u zbuluar dhe hetuar pa bashkëpunimin e të paktën një prej pjesëmarrësve. Interesi i konsumatorëve dhe qytetarëve në zbulimin e këtyre marrëveshjeve të fshehta/karteleve, me qëllim që të ndalohej dhe përfundohet shkelja dhe të dënohen shkelësit, ka më shumë rëndësi se sa interesi për gjobitjen e këtyre ndërmarrjeve për sjellje të paligjshme.

Marrëveshjet e fshehta/kartel, janë ato marrëveshje dhe / ose praktika të bashkërenduara ndërmjet konkurrentëve që kanë për qëllim kufizimin e konkurrencës nga koordinimi i sjelljes së tyre konkurruese ose ndikojnë përkatësisht në parametrat e konkurrencës. Pjesëmarrësit në kartel, në mënyrë tipike veprojnë bashkërisht për të fiksuar çmimet e tyre të blerjeve apo çmimet e shitjes, dhe / ose të ndajë prodhimin ose shitjet e pjesëve të tregut dhe / ose për të ndarë tregjet. Këto praktika të karteleve, përfshijnë aranzhime të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi ndikojnë tek çmimi, volumet, pjesët e tregut dhe parametrat e tjerë përkatëse të konkurrencës. Për shembull, praktikatat e fshehta të tilla si kufizimet për importet ose eksportet, bid-rigging ose bojkotet e përbashkëta janë objekt i zbatimit të programit.

Llojet e tjera të kufizimit, janë zakonisht më pak të vështira për të zbuluar dhe / ose hetuar dhe për këtë arsye nuk e justifikojnë trajtimin në kuadrin e një programi lehtësimi. Përveç

kësaj, përfshirja e marrëveshjeve të tjera përveç karteleve dhe aplikimi i programit, mund të rrezikojnë për të ri-futur një lloj de facto sistem njoftimi që do të ishte e padëshirueshme. Nuk përjashtohet, megjithatë, rasti kur një kartel që përfshin elemente vertikale, të mund të jetë objekti i lehtësimit nga gjoba.

Programi përmban dy pragje të ndryshme për dhënien e imunitetit:

1- Një nga ndërmarrjet e para, që i siguron Autoritetit të Konkurrencës (AK) dëshmi të mjaftueshme për të mundësuar kryerjen e inspektimeve të caktuara në lidhje me një kartel të mundshëm ; dhe

2- Një nga ndërmarrjet e para që i siguron AK, dëshmi të mjaftueshme të cilat nga këndvështrimi i AK mund të përbejnë shkelje të nenit 4 të ligjit në lidhje me një kartel të mundshëm.

Nuk mund të zbatohen të dy llojet në të njëjtën kohë (Imuniteti nuk është me i vlefshëm sipas pikës 2 nëse është dhënë një here sipas pikës 1) .

Në rastet e pikës 1), duhet që aplikuesi t'i sigurojë AK informacion të mjaftueshëm për të lejuar kryerjen e inspektimeve të caktuara. Vlerësimi i pragut do të duhet të kryhet ex ante, d.m.th pa marrë parasysh nëse një inspektim i dhënë rezulton ose jo i suksesshëm ose nëse një inspektim është kryer ose jo. Vlerësimi do të bëhet ekskluzivisht në bazë të llojit dhe cilësisë së informacionit të paraqitur nga kërkuesi. Lista e informacioneve, e përshkruar me në detaje më poshtë, duhet të shërbejë si Udhëzim për aplikuesit që të parashikojnë atë që kërkohet zakonisht nga Autoriteti i Konkurrencës.

Ne mënyrë që të plotësohen kushtet për pikën 1), ndërmarrjet në përgjithësi duhet të jenë në pozicion për t'i siguruar AK informacion dhe dëshmitë e mëposhtme:

- Emrin dhe adresën e personit juridik që aplikon për imunitetin, si dhe emrat e personave që janë apo kanë qene përfshirë në kartelin e pretenduar në emër të saj;
- Identitetin e të gjitha ndërmarrjeve të tjera të cilat marrin pjesë (ose kanë marre) në kartelin e mundshëm si edhe individët të cilët, nga sa ka njohuri aplikanti, janë apo kanë qenë të përfshirë në kartelin e mundshëm;
- Një përshkrim i detajuar i sjelljes së kartelit të mundshëm, duke përfshirë për shembull synimet e saj, aktivitetet dhe funksionimin; Produkti (et) ose shërbimi (et) në fjale, mbulimi gjeografik, kohëzgjatja dhe volumi i llogaritur i tregut i ndikuar nga karteli i mundshëm; datat, vendndodhja, përmbajtja apo pjesëmarrja e kontakteve të kartelit në fjale; te gjitha shpjegimet lidhur me faktet e siguruar ne mbështetje të aplikimit;
- Provat në lidhje me kartelin e mundshëm të poseduara nga aplikuesi ose në dispozicion të tij në kohën e depozitimit të aplikimit, në veçanti dëshmi të poseduara; dhe
- Informacion mbi të cilën AK te tjera, brenda apo jashtë BE-së, kanë trajtuar ose po trajtojnë një aplikim nga aplikuesi lidhur me kartelin e mundshëm.

Nëse Autoriteti ka kryer një inspektim, ose tashmë ka në pronësi të tij dëshmi të mjaftueshme për të kryer një inspektim, imuniteti sipas pikës 1), nuk do të jetë me i mundur.

### *Aplikantet e përjashtuar*

Një ndërmarrje e cila ka ndërmarrë hapa për të detyruar një ose më shumë ndërmarrjeve që të bashkohen ose të qëndrojnë në kartel, ne parim, përjashtohen nga përfitimi i imunitetit. Ligjërisht, ndalohet që një ndërmarrje që ka luajtur një rol të tillë të shpëtojë nga te gjitha sanksionet. Shtrirja e përjashtimit është e ngushtë, megjithatë, në mënyrë që të shmangin krijimin e pasigurisë për aplikantët potencial.

### **5. Lehtësimi i pjesshëm/Reduktimi i gjobës**

Është në interesin e AK, të ruajë bashkëpunimin me ato ndërmarrje të cilat nuk kualifikohen për lehtësim/imunitet të plotë, ose për shkak se nuk arrijnë të përmbushin prapë prapë përkatës ose për shkak të rolit që ata kanë luajtur në kartel. Një bashkëpunim i tillë siguron që pjesëmarrja në një kartel dhe aktivitetet në një kartel, të jenë më të hetuarat dhe me të penalizuarat.

Vlera e bashkëpunimit varet nga koha (përfshirë faktin nëse aplikanti ishte i pari, i dytë ose i tretë, etj në radhë për të aplikuar) natyra dhe cilësia e provave të paraqitura. Ka mënyra të ndryshme të kombinimit të këtyre parametrave për të shpërblyer kontributin e aplikantit. Megjithatë, të gjitha sistemet duhet të sigurojnë se ka një dallim të madh mes lehtësimit të plotë/ imunitetit nga gjobat dhe lehtësimit të pjesshëm/reduktimit të gjobave në mënyrë që t'i bëjnë aplikimet për imunitet sa më tërheqëse të jetë e mundur për ndërmarrjet. Vlera e shtuar në rastin e reduktimit nga gjobat nuk duhet, të shpërblehet me një reduktim gjobe prej më shumë se 50%.

Aplikantët janë të detyruar që të sjellin fakte që në këndvështrimin e AK-së përbëjnë vlerë të konsiderueshme të shtuar, në lidhje me provat tashmë në zotërim të Autoritetit në kohën e dorëzimit të aplikimit. AK në përgjithësi merr në konsideratë dëshmitë me shkrim që origjinojnë nga periudha të cilës i përkasin, dhe si të tilla kanë një vlerë më të madhe sesa të dhënat e tashmë krijuara dhe dëshmitë përkatëse inkriminuese direkt të lidhura me faktet në fjalë. Këto informacione në përgjithësi do të konsiderohen me vlerë më të madhe se ato me vetëm evidencë indirekte.

Në mënyrë të ngjashme, shkalla e vërtetimit nga burime të tjera të nevojshme të cilave u është kërkuar të mbështesin dëshmitë e depozituara, do të kenë ndikim në vlerën e asaj prove.

### **Kushtet bashkëlidhur lehtësimit**

Kualifikimi për të përftuar lehtësimin i jepet aplikantit, me kusht që tre kushte kumulative të jene plotësuar. (Vlerësimi përfundimtar i përputhjes së plotë me kushtet për përfitim të lehtësimit bëhet në fund të procedurës hetimore).

**Kushti i parë** ka të bëjë me ndërprerjen e kartelit. Ndërmarrjet duhet të ndërpresin të gjitha aktivitetet pjesëmarrëse të tyre në marrëveshjen e ndaluar/kartel sa më shpejt të jetë e mundur. Megjithatë, përvoja tregon se ndërprerja e menjëhershme, p.sh. mungesa e papritur dhe e pashpjegueshme në takimet e rregullta të karteleve, pas aplikimit dhe para se AK të ndërmarrë inspektime, mund të dëmtojë seriozisht efikasitetin e inspektimeve pasuese, duke sinjalizuar

pjesëmarrësit e tjerë të kartelit dhe i lejon ata të fshehin ose shkatërrojnë provat. Prandaj, është në interesin e publikut, vonesa në dhënien fund të marrëveshjes së ndaluar, deri në momentin e duhur për të mbrojtur integritetin e inspektimit. Ky kufizim nga rregulli i përgjithshëm, pranohet vetëm kur është e nevojshme dhe synohet të arrihet ekuilibri i duhur midis dhënies fund të veprimtarive të paligjshme të aplikantit sa më shpejt të jetë e mundur dhe mbrojtjen e efektivitetit të Hetimit të AK-së. Kjo është gjithashtu e nevojshme për të lejuar koordinimin mes Autoriteteve të ndryshme në rast të procedurave paralele dhe për të shmangur ekspozimin e aplikuesit. Nevoja për të vazhduar pjesëmarrjen në një kartel të caktuar duhet të diskutohet mes aplikantit dhe AK në një fazë shume të hershme.

**Kushti i dytë** është detyrimi për të bashkëpunuar me AK përgjatë procedurës. Ky detyrim është një tipar thelbësor i programit të lehtësimit. Ajo fillon nga data e aplikimit në AK dhe zgjat gjatë gjithë procedurës. Në këtë drejtim, nuk ka asnjë arsye për t'i dalluar aplikantët për imunitetin dhe reduktimin e gjobave. Në të gjitha rastet, bashkëpunimi duhet të jetë i vërtetë, pra, ndihma nga aplikantit, përveç se duhet të jete gjithëpërfshirëse dhe e menjëhershme, duhet të zbulojë një shpirt të vërtetë bashkëpunues. Ajo ka aspekte të ndryshme dhe për këtë arsye lista e detyrave që mund të nxirren është domosdoshmërisht jo-shteruese. Ajo përfshin ndër të tjera:

- Duke siguruar pa vonesë, çdo prove ekzistuese dhe informacionin që është në dispozicion të aplikantit ose ndodhet në pronësi të tij ose nën kontrollin e tij gjatë hetimit;
- Përgjigjen pa vonesë, të çdo pyetje nga AK dhe të bëjnë të mundur dhe të disponueshëm ish-punonjësit dhe drejtorët në dispozicion për intervistat me AK. Kjo përfshin, ndër të tjera, të gjithë informacioni përkatës dhe materialet për të mbështetur aplikimin për lehtësim që mund të jetë në posedim të një punonjësi ose një drejtori para largimit të tyre apo largimit vullnetar;
- Mos shkatërrimin, falsifikimin ose fshehjen e provave që janë objekt i fushës së aplikimit pas aplikimit për lehtësim;
- Faktet e pa-zbuluara (te drejtpërdrejta ose tërthorta) apo ndonjë informacion nga përmbajtja e aplikimit për lehtësim para se AK të ketë njoftuar kundërshtimet e saj për palët.

Detyrimi i mos-zbulimit të aplikimit nuk do të konsiderohet i shkelur nëse aplikanti informon një tjetër autoritet konkurrence për ekzistencën ose përmbajtjen e kërkesës për lehtësim, në kontekstin e aplikimeve të shumta të bëra nga i njëjti aplikant për lehtësim. Në mënyrë të ngjashme, detyrimi i mos-zbulimit nuk do të konsiderohet i shkelur nëse aplikanti merr një avokat të jashtëm për qëllim të marrjes së këshillave ligjore, me kusht që aplikanti të japë siguri që avokati i jashtëm nuk do të nxjerre asnjë informacion për ndonjë palë e tretë.

Vetëm nëse autorizohet ndryshe nga AK, aplikanti detyrohet që të zgjasë kohëzgjatjen e mos-zbulimit të paktën deri sa AK të paraqesë kundërshtimet e saj/raportin e hetimit për palët. Autoriteti i konkurrencës mund ta aplikojë detyrimin për një periudhë më të gjatë, përtej njoftimit të kundërshtimeve të palëve, për shembull gjatë gjithë procedurës. Aplikantët për lehtësim nga gjoba që kanë dorëzuar aplikime të shumta në disa Autoritete janë të inkurajuar për të verifikuar me kujdes gjatë gjithë kohëzgjatjes së procedurave në AK të ndryshme deri kur detyrimi i mos-zbulimit të jete i zbatueshëm për ta në çdo regjim lehtësimi, në mënyrë që të përputhen me të gjitha.

**Kushti i tretë** kërkon që aplikuesi, nuk duhet qe, (kur mendon te beje një aplikim për lehtësim ne AK por para se të veproje):

- a) te shkatërrojë provat që janë objekt i aplikimit; ose
- b) të zbulojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, fakte apo ndonjë element nga përmbajtja e aplikimit.

Dështimi për te qene ne përputhje të plotë me ndonjë nga këto kushte do ta s’kualifikoje aplikuesin nga programi i lehtësimit në procedurat përkatëse.

Aplikuesi është i inkurajuar për të informuar AK përpara ndonjë shkarkimi të parashikuar të një punonjësi ose drejtori i cili mund të zotërojë informacione dhe materiale përkatëse, në lidhje me aplikimin për lehtësim.

## **6. Procedurat e lehtësimit nga gjobat**

Autoriteti i Konkurrencës, regjistron aplikimin dhe ruan vendin e aplikantit në radhë për një periudhë të caktuar kohe. Aplikanti mbrohet nëpërmjet një “shënjesi“, i cili vendoset nga Autoriteti dhe mbron vendin e aplikuesit në radhë për një periudhë të caktuar kohore.

Kjo i jep aplikuesit kohën e duhur për të mbledhur Informacionin e kërkuar dhe prova për të arritur pragun e kërkuar nga Autoriteti.

Shënjesi është në diskrecionin e Autoritetit. Ka raste kur disa Autoritete konkurrence mund të zgjedhin që të vendosin shënjesin vetëm atëherë kur është e qartë që do të jepet imuniteti/lehtësimi nga gjoba dhe ka autoritete të tjera të cilat vendosin shënjesin (japin shënjesin) në çdo rast aplikimi. Në çdo rast vetë Autoriteti vendos në lidhje me kohëzgjatjen e shënjesit.

Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës specifikon llojin e informacionit të kërkuar me qëllim dhënien e shënjesit. Kjo është e baraz-vlefshme me atë çfarë kërkohet për të depozituar aplikimin (ndërkohë që praktika njih edhe raste kur një autoritet mund të vendosë që të mbrojë radhën e aplikuesit mbi baza të një informacioni të kufizuar, në varësi të çështjes që shqyrtohet). Në çdo rast, aplikuesi duhet minimalisht të japë informacion në lidhje me emrin dhe adresën e tij dhe të plotësojë pritshmëritë e Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës me baza konkrete në lidhje me pjesëmarrjen në një sjellje karteliste.

Autoriteti i Konkurrencës, informon aplikuesin sa më shpejt ë jetë e mundur në lidhje me statusin e aplikimit të tij dhe që ka marrë dijeni në lidhje me depozitimn e aplikimit.

Nëse Autoriteti jep imunitet, nuk do të vendoset gjobë mbi aplikuesin në lidhje me kartelin për të cilin ai ka aplikuar, me kushtin që detyrimet që i bashkëngjiten lehtësimit nga gjoba janë përmbushur përgjatë procedurës hetimore dhe kur nuk evidentohet fakti që aplikuesi ka qenë drejtuesi apo ka ushtruar forcë për këtë sjellje kartel.

AK nuk do të përpunojë aplikimin e depozituar, pra nuk do të japë ose mohojë lehtësimin nga gjobat. Autoriteti i konfirmon aplikantit se do të ketë një periudhë të caktuar kohore, në të cilën duhet të përfundojë aplikimin. AK më vonë duhet t’i kërkojë aplikantit, të bëjë një aplikim të plotë.

**7. Deklaratat nën programin e lehtësimit dhe procedura verbale**

Programi i Lehtësimit nga gjobat lejon edhe aplikimet verbale (përmbledhje, shënime ose aplikime te plota) në të gjitha rastet kur kjo është e justifikuar dhe proporcionale. Në këtë rast, nuk do të jepet akses për çfarëdo evidence të çdo deklarate (gojore dhe me shkrim) para se të jetë hartuar dhe dërguar palëve, raporti i hetimit.

Autoriteti i Konkurrencës

Rruga “Sami Frasheri” nr. Iv, Kati 4, Tirane Albania;

Web: [www.caa.gov.al](http://www.caa.gov.al)

E-mail: [Competition@caa.gov.al](mailto:Competition@caa.gov.al)

TELEFON: 00355 4 2 234 504

FAX: 00355 4 2 234 497